

TERMAT E REFERENCËS

Projekti: “Qasje e Përbashkët drejt Ekonomisë Qarkulluese Blu për Rajonin Adriatik dhe Jon” (JOINT approach to Blue circular Economy – for Adriatic and Ionian Region) JOINABLE

Thirrje për konsulencë: Konsulent për Ekonominë Qarkulluese

Pozicioni: Konsulent për Ekonominë Qarkulluese

Vendi i Punës: Nga shtëpia (me udhëtime të mundshme sipas nevojës në Bashkinë Divjakë)

Data e parashikuar e fillimit: 3 Gusht 2026

Data e parashikuar e përfundimit: 25 Gusht 2027

Totali i Ditëve të Punës: Deri në 60 ditë pune për periudhë projekti (të shpërndara gjatë periudhës së angazhimit dhe të dakordësuara me menaxheren e projektit)

1. Informacion i Përgjithshëm

Projekti JOINABLE është një nismë ndërkombëtare e bashkëfinancuar nga programi Interreg IPA ADRION, që bashkon nëntë partnerë nga gjashtë vende të ndryshme, si Itali, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëri dhe Greqi. Projekti synon të krijojë dhe të promovojë një ekonomi qarkulluese blu duke adresuar sfidën e vazhdueshme të mbetjeve detare dhe të ujërave të ëmbla në të gjithë rajonin Adriatiko-Jon.

Projekti ndjek një qasje me shumë nivele që përfshin:

- (i) analizën e kuadrit ligjor dhe politik;
- (ii) zhvillimin e planeve të përbashkëta të veprimit dhe strategjive;
- (iii) veprime pilot dhe demonstrim që shndërrojnë mbetjet në produkte;
- (iv) zhvillimin e planeve të biznesit për NVM-të;
- (v) krijimin e një sallë ekspozite dhe materialeve komunikimi për të shfaqur produktet dhe zgjidhjet e ekonomisë qarkulluese.

Bashkia Divjakë, si partnere e projektit, po kërkon një ekspert / kompani (të përmbledhura në termin konsulenti), që do të ofrojë shërbimin e konsulentit të ekonominë qarkulluese për një sërë paketash pune dhe produktesh, të cilat duhet të dorëzohen në kuadër të projektit JOINABLE.

2. Objektivat e Detyrës dhe Përgjegjësitë

Objektivi i përgjithshëm i kësaj konsulence është të ofrojë ekspertizë të nivelit të lartë mbi parimet, politikat dhe modelet e biznesit të ekonomisë qarkulluese për të mbështetur Bashkinë Divjakë në përmbushjen e detyrimeve të saj në projekt. Konkretisht, konsulenti do të kontribuojë në:

- Hartimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për Ekonominë Qarkulluese Blu (Aktiviteti 1.3.1);
- Hartimin e materialeve për të mbushur Sallën e Ekspozitës së Ekonomisë Qarkulluese të Projektit në zonën e ekspozitës së Partnerit Udhëheqës (Aktiviteti 3.2.2);
- Kontribut me materiale për prodhimin e videos për produktet dhe zgjidhjet e ekonomisë qarkulluese blu (Aktiviteti 3.2.3);
- Hartimin e Planit të Veprimit për shfrytëzimin e rezultateve me Planin e Biznesit për NVM-të të drejtuar nga ekonomia qarkulluese blu (Aktiviteti 3.3.1);
- Hartimin e pjesës së Bashkisë Divjakë për Strategjinë për Ekonominë Qarkulluese Blu për Rajonin Adriatik dhe Jon që do të koordinohet nga partneri kryesorë i projektit (Aktiviteti 4.1.1).

3. Fusha e Punës dhe Produktet e Kërkuara

Konsulenti do të angazhohet për një total prej deri në 60 ditë pune gjatë periudhës Gusht 2026 – Gusht 2027 (Periudhat 5 dhe 6 të projektit), me punën të shpërndarë, si më poshtë:

- Faza 1: Periudha 5 (Gusht 2026 – Shkurt 2027) – Deri në 30 ditë pune

Produkti 1: D.1.3.1 – Plani i Përbashkët i Veprimit për ekonominë qarkulluese blu

Përshkrimi: Kontribuoni në finalizimin e Planit të Përbashkët të Veprimit (i nisur në WP1) duke ofruar ekspertizë për ekonominë qarkulluese, duke siguruar përputhjen me politikat e BE-së (Marrëveshja e Gjellbër Evropiane, Plani i Veprimit për Ekonominë Qarkulluese) dhe duke përfshirë mësimet e nxjerra nga veprimet pilot.

Afati Kohor: Gusht – Tetor 2026

Produkti 2: D.3.2.2 – Salla e Ekspozitës së Ekonomisë Qarkulluese të Projektit

Përshkrimi: Ofrim i këshillave dhe materialeve për dizajnimin dhe përmbajtjen e sallës së ekspozitës, duke siguruar që ajo të demonstrojë në mënyrë efektive parimet e ekonomisë qarkulluese dhe zinxhirin e vlerës nga mbetjet në produkt.

Afati Kohor: Nëntor – Dhjetor 2026

Produkti 3: D.3.2.3 – Video për produktet dhe zgjidhjet e ekonomisë qarkulluese blu

Përshkrimi: Krijimi i narrativës dhe mesazheve kryesore për videon, duke theksuar udhëtimin e ekonomisë qarkulluese nga mbetjet detare të produktet e gatshme dhe duke siguruar saktësinë teknike.

Afati Kohor: Janar – Shkurt 2027

Produkti 4: D.3.3.1 – Plani i Veprimit për shfrytëzimin e rezultateve me Planin e Biznesit për NVM-të

Përshkrimi: Draftimi i Planit të Veprimit dhe Planit të Biznesit, duke ofruar ekspertizë për modelet e biznesit qarkullues, analizën e tregut, zhvillimin e zinxhirit të vlerës dhe qëndrueshmërinë financiare për NVM-të në Divjakë.

Afati Kohor: Nëntor 2026 – Shkurt 2027

- Faza 2: Periudha 6 (Mars 2027 – Gusht 2027) – Deri në 30 ditë pune

Produkti 5: D.4.1.1 – Strategjia për ekonominë qarkulluese blu për rajonin Adriatik dhe Jon

Përshkrimi: Hartimi i pjesës së Bashkisë Divjakë në Strategjinë e Përbashkët. Kjo përfshin integrimin e të gjitha të dhënave të projektit, identifikimin e rekomandimeve të politikave dhe përcaktimin e një rruge të qartë për zhvillimin e ekonomisë qarkulluese blu në rajonin ADRION.

Afati Kohor: Mars – Qershor 2027

Produkti 6: Finalizimi dhe sigurimi i cilësisë për të gjitha produktet e dorëzueshme

Përshkrimi: Rishikimi dhe finalizimi të gjitha dokumentet për të siguruar koherencën, cilësinë dhe përputhjen me objektivat e projektit dhe standardet e BE-së, duke dhënë kontribute për raportimin përfundimtar të projektit.

Afati Kohor: Korrik – Gusht 2027

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Konsulenti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare (Master ose për lart) në Ekonomi, Juridik, Shkenca Mjedisore, ose një fushë e lidhur me specializimin në Ekonominë Qarkulluese, Politikat, Zhvillimin e Qëndrueshëm ose Menaxhimin Mjedisor.
- Minimumi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e ekonomisë qarkulluese, fushave me impakt në mjedis ose në fusha të lidhura me projektin.

- Përvojë e provuar në draftimin e strategjive, planeve të veprimit dhe planeve të biznesit, mundësisht në lidhje me ekonominë qarkulluese dhe/ose në një kontekst evropian ose ndërkombëtar.
- Njohuri të forta të politikave të BE-së në lidhje me ekonominë qarkulluese, duke përfshirë Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, Planin e Veprimit për Ekonominë Qarkulluese dhe direktivat përkatëse për mbetjet dhe plastikën.
- Aftësi të shkëlqyera analitike, kërkimore dhe shkrimi, me aftësinë për të përmbledhur informacionin në dokumente të qarta dhe të zbatueshme.
- Aftësi e lartë në gjuhën angleze (të shkruar dhe të folur) është e detyrueshme.

Përvojë të dëshirueshme:

- Përvojë pune në projekte të financuara nga BE, veçanërisht programet Interreg ose Horizon.
- Njohje me ekonominë blu dhe menaxhimin e mbetjeve detare.
- Njohje e kontekstit socio-ekonomik të rajonit ADRION (Itali, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëri, Greqi).
- Përvojë në zhvillimin e modeleve të biznesit dhe zinxhirëve të vlerës për NVM-të.

7. Menyrat e aplikimit

Ekspertët konsulentë të interesuar janë të ftuar të paraqesin:

Për personat fizik konsulentë:

- Një CV të detajuar që thekson përvojën dhe kualifikimet përkatëse.
- Një propozim teknik që përshkruan qasjen ndaj detyrës.
- Një propozim financiar që tregon tarifën ditore në Euro (Oferta financiare - Aneksi A)

Për kompanitë e konsulencës:

- CV e kompanisë/ portofolit të shërbimeve të ngjashme.
- NIPT/ Ekstrakt QKB
- Një propozim financiar që tregon tarifën ditore në Euro (Oferta financiare - Aneksi A)

Data e parashikuar e fillimit të punës: 3 Gusht 2026

Afati i fundit për aplikime: 17 Korrik 2026, ora 23:59. Aplikimet pas këtij afati, nuk do të konsiderohen.

Nderkohe për pyetje, jeni të lutur t'i drejtoni deri në datën **08/07 Korrik**, tek adresa: esmeralda.harizi@bashkiadivjake.gov.al

Bashkia Divjakë do të kontraktojë ekspertin / kompaninë, oferta e të cilit është më e përshtatshme për projektin, sipas vleresimit të një komisioni specifik. Vleresimi do të realizohet sipas ndarjes:

<i>Fusha</i>	<i>Përqindja</i>
Edukimi dhe eksperiencat e mëparshme	70 %
Oferta financiare	30%

8. Raportimi

Eksperti do të raportojë drejtpërdrejt te Menaxheri i Projektit të Bashkisë Divjakë dhe do të punojë në koordinim të ngushtë me Partnerin Udhëheqës (Bashkia Punat) dhe partnerët e tjerë të projektit sipas nevojës. Përditësime të rregullta të progresit dhe takime koordinimi (virtuale) do të planifikohen për të siguruar përputhjen me afatet kohore dhe objektivat e projektit.

9. Financimi

Pagesa për shërbimin e kryer do të realizohet pas përfundimit të suksesshëm të çdo periudhe, në monedhën Lek, tek llogaria bankare e subjektit sipas dakordësisë dhe kushteve të vendosura në kontratën e lidhur me Bashkinë Divjakë.

10. Shënim

Për këtë ekspertizë preferohen kandidatët që operojnë në Bashkinë Divjakë. Ky dokument i Termave të Referencës bazohet në dokumentacionin e projektit të dhënë dhe mund t'i nënshtrohet rregullimeve në konsultim me konsulentin e suksesshëm dhe ekipin koordinues të projektit.